

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

Komisioni i Përherëshëm i “Shëndetësisë, Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazise Gjinore”

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Nr. 4 datë 30.07.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit Datë 30.06.2025, relacionit e dokumentat

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.07.2025-31.07.2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.07-31.07 2025”.

BAZA LIGJORE

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” bazuar në Udhëzimin nr.4, datë 17.02.2017, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7 dhe Vendimi Nr. 868, datë 29.12.2021, masa e ndihmës ekonomike llogaritet:

Situata aktuale e funksionit a) 2,178 (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë lekë) për anëtarin e parë të familjes në certifikatën familjare;

b) 1,525 (njëmijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë për anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç;

c) 1,089 (njëmijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë për anëtarët që janë nën moshën 18 vjeç;

d) 3,146 (tremijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekë, kur familja është e përbërë vetëm nga një anëtar i cili është mbi moshë pune, si dhe Udhëzimit nr.4, datë 17.02.2017, për “Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok – Ndhmën Ekonomike deri në 6%”.

Në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 86 datë, 12.12.2024 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025” është miratuar fond “Ndhma Ekonomike” me fond limit 2.000.000 lekë/ vit.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet) :S KA

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh: Monitoron komisioni i “Shendetesise, mirëqënies sociale, rinisë dhe barazise gjinore”, dhe keshilli bashkiak cdo muaj dhe sa here sheh ai të nevojshme

Impakti social / grupet që preken:

Kanë përfituar ndihmë ekonomike për muajin Korrik 2025	89
• individë/ familje përfituese nga sistemi i pikëzimit nga të cilat:	85
familje përfitues nga aplikimi i ndihmës ekonomike	38
individ status jetimi	37
individë,viktima dhunë në familje	3
fëmijë të vendosur në familje kujdestare	7
Janë skualifikuar 7 individë/familje pasi; 5- rezultojnë me pikë të pamjaftueshme, 2– ka perfundyar periudha e vleshëris.	

Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë:

Të trajtohen me Ndihmë Ekonomike për muajin Korrik 2025 nga Fondet e Bashkisë 47 familje në vlerën 140,540 lekë, individ/familje sipas kriterëve të miratuara

A është objekt i konsultimit Publik: Jo

Komisioni i Përhershëm për “ Shëndetësisë, mirëqënies sociale, rinisë dhe barazisë gjinore”, i mbledhur me datën _____ 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr date 30.06.2025 relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin :

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.07.2025-31.07 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.07-31.07 2025”.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni e me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Anila Lacaq Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma) Sekretar i Komisionit

Datë _____ 2025